



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**10.01.2018, Prishtinë,
Ref:01.12.2017\587-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, në mbledhjen e bordit të mbajtur më 19 dhjetor 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "Balotazh nëntoke, qytetarët të ndëshkojnë kryetarët e dështuar", botuar më 2 nëntor 2017, dhe nxorri këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se gazeta i cilëson Devollët si mafio-oligark dhe të inkriminuar, por nuk paraqet argumente.

KMShK, pasi e shqyrtoi ankesën dhe artikullin e lartëpërmendur vendosi se gazeta ka bërë shkelje të Kreut II (Raportimi i së vërtetës), pasi që gazeta ka botuar vetëm prononcimet e një grupi të analistëve të saj, pa i mundësuar edhe kompanisë Devolli që të prononcohet ose ndonjë organi kompetent apo ndonjë burimi të pavarur në mënyrë që të krijohej një pasqyrë më e qartë rreth temave që i ka shqyrtuar në artikull. Në këtë mënyrë edhe lexuesi do të përfitonte duke pasur parasysh se do të krijohej një spektër i gjerë i pikëpamjeve dhe fakteve në të mirë të së vërtetës.

Gjithashtu, KMShK konstatoi se gazeta nuk ka botuar asnjë prononcim të palës tjetër për çka ka qenë e obliguar sipas Kodit të Mediave të Shkruara, me çka do të përmbushej obligimi që del nga Kreu IV (E drejta për t'u përgjigjur) i Kodit të Mediave të Shkruara.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij opinioni.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës